



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2553/prot.
5

Tiranë, më 27 / 09 / 2019

VENDIM
Nr. 56, datë 27.09.2019

PËR
NISJEN E PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR
PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË

Në bazë të nenit 3, 38, 46 e vijues ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 32, 33 e në vijim të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe pas diskutimeve sipas rendit të ditës, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Të nisë procedurat përkatëse për krijimin e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, dhe përzgjedhjen e anëtarëve të tij.
2. Komisioni i përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përbëhet prej 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarësh, të cilët kanë mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Anëtarët e këtij komisioni janë personel akademik me kohë të plotë në UMT, të cilët mbajnë titullin akademik “Profesor” dhe përzgjidhen nga Senati Akademik pas vetëkandidimit të tyre.
4. Kriteret që do të plotësojnë kandidatët do të përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.
5. Vendimi i Senatit Akademik nr.63, datë 25.10.2018 “Për krijimin e Komisionit të Përhershëm...”, shfuqizohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe iu njoftohet njësisë kryesore të UMT-së.

KRYETARI
ARBEN GJATA

